

Të nderuar kolegë,

Edukimi në vazhdim është një proces që ka nisur në vitin 2010. Cikli i parë i procesit të riçertifikimit përfundon në dhjetor të vitit 2014. Të gjithë farmacistët deri në fund të këtij cikli duhet të kenë përfituar 100 kredite në total. Përrjashtohen nga ky numër kreditesh profesionistët të cilët janë bërë anëtarë të UFSH pas vitit 2010, numri i kreditëve të të cilëve përcaktohet nga viti i antarësimit në UFSH.

Numri i krediteve që profesionistët duhet të përfitojnë deri në fund të vitit 2014 është si më poshtë:

- Farmacistët e anëtarësuar në UFSH deri më datën 30 Prill 2010, duhet të kenë 100 kredite në total.
- Farmacistët e anëtarësuar në UFSH nga data 1 Maj 2010 – 30 Prill 2011 duhet të kenë 80 kredite në total.
- Farmacistët e anëtarësuar në UFSH nga data 1 Maj 2011 – 30 Prill 2012 duhet të kenë 60 kredite në total.
- Farmacistët e anëtarësuar në UFSH nga data 1 Maj 2012 – 30 Prill 2013 duhet të kenë 40 kredite në total.
- Farmacistët e anëtarësuar në UFSH nga data 1 Maj 2013 – 30 Prill 2014 duhet të kenë 20 kredite në total.
- Farmacistët e anëtarësuar në UFSH nga data 1 Maj 2014 – e në vazhdim nuk kanë detyrime për kredite për këtë cikël.

Ju bëjmë me dije se, nëse numri i krediteve që ju nevojiten për këtë cikël riçertifikimi tejkalohet, këto kredite nuk mbarten në ciklin pasardhës. Gjithashtu, ju sqarojmë se këto kredite mund të përfitohen, jo vetëm nga ndjekja e seminareve dhe konferencave të akredituara të cilat ofrohen nga UFSH apo ofrues të tjerë të këtij shërbimi, por gjithashtu edhe nga plotësimi i **Formularit të vetëraportimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim** mbi leximin individual të literatusës përkatëse.

Më poshtë mund të gjeni formularin i cili duhet të plotësohet dhe të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Me postë zyrtare:

QKEV, Rr. Aleksander Moisiu, Nr.84, Tirane, Shqiperi

Me postë elektronike (e-mail) :

info@qkev.gov.al

<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i një DVD/CD (titulli i DVD/CD) 	Shëno autorin, vitin e botimit.	0.5/për DVD/CD
<ul style="list-style-type: none"> • Vizitë studimore 	Shëno institucionin/departamentin shëndetësor, shtetin, kohëzgjatjen.	5/për vizitë
<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrje në kërkim/studim (titulli i studimit) 	Shëno autorin/ët, vitin, rolin tuaj në këtë aktivitet.	4/kërkim
Kredite gjithsej		

Deklaroj se aktivitetet e mësipërme janë raportuar me vërtetësi.

Nënshkrimi
